

**STATUT  
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“ DARIO CONSTRUCTION ”**

Ne baze e ne zbatim te ligjit

- Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” me poshte referohet si “Ligji Per Shoqerite”,
- Nr.7512 date 10.08.1991 “ Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit”;
- Nr.9723 , date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”;

veprimtaria e shoqerise

**“ DARIO CONSTRUCTION ” sh.p.k.**

do te organizohet dhe do te drejtohet sipas ketij Statuti te trajtuar ne te njejeten dokument me Aktin e Themelimit.

**PJESA E PARE  
DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Neni 1  
Ortaket**

1.1 Ortaket e shoqerise jane :

**1. ESMERALDA QAFA** , shtetase Shqiptare , lindur me 22 Prill 1981 ne Bajram Curri , banuese ne Tirane, Shqiperi , mbajtes i leternjoftim nr 034003652 dhe numer personal I 15422048 D, madhor dhe me zotesi juridike te plete per te vepruar.

**Neni 2  
Emri**

Emri i shoqërisë është **DARIO CONSTRUCTION sh.p.k.**, (më poshtë referuar si “Shoqëria”).

**Neni 3**

**Selia e Shoqerise**

- 3.1 Selia e Shoqerise eshte ne adresen: **“Tirane Rruga Don Bosko , Zona kadastrale 8310 pasuria nr 6/494-N4 .**
- 3.2 Shoqëria mund te hapë degë, zyra përfaqësimi brenda apo jashtë Republikës se Shqipërisë ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

**Neni 4**



## **Forma ligjore**

**4.1. Shoqëria është shoqëri shqiptare dhe është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.**

### **Neni 5 Kohëzgjatja**

**5.1. Shoqëria do te ushtroje aktivitetin e saj tregtar per një periudhe te pacaktuar (pakufizuar).**

### **Neni 6 Objekti i aktivitetit**

Objekti i veprimtarise se shoqerise "**DARIO CONSTRUCTION sh.p.k.**", konsiston ne :

1. Investime ne fushen e ndertimit , ne pasuri te paluajtshme , : Projektimi dhe zbatimi i veprave ndertimore si vijon: Ndertime me karakter civil dhe ekonomik, punime, germime dhe sistemime dhei, tarracime terrenesh, veshje fasadash, ndertime rrugesh, asfaltime, etj. Prodhim dhe tregtim me shumice dhe pakice te materialeve inerte si beton, asfalto-beton etj. Zhvillimi dhe ndermjetesimi i projekteve per rikonstruksionin e ndermarrjeve industriale, sigurimi i projekteve industriale ashtu si dhe strukturimi i kontratave afatgjata per levrime dhe mbi bazen e ketij rifinancimi dhe kreditimi. Prodhimi dhe tregtimi me shumice dhe pakice i materialeve te ndertimit, import eksport i tyre brenda dhe jashte vendit per llogari te shoqerise si dhe te te treteve. Hapjen e zyrave, organizimin e kurseve dhe mbajtjen e seminareve me qellim zbatimin e rregullave te sigurimit teknik ne fushen e ndertimeve
  2. Zbatim i veprave ndërtimore si vijon : Punime karpenterie, ndërtime me karakter civil dhe industrial ,perpunim vendosje dhe lidhje hekuri industrial , punime gërmimi dhe sitemimi dhei ,tarracime terrenesh , rikonstruksione godinash civile dhe industriale ,veshje fasadash , ndërtime urash dhe konstruksione metalike, montime panelesh ,ndërtime rrugësh ,ASFALTIME, hapje kanalesh si dhe cdo ndërtim tjeter me karakter civil dhe industrial .
  3. Transport per vete dhe per te trete brenda dhe jashte vendit.
- 6.2. Shoqeria mund te kryeje edhe aktivitete te tjera shtese, me qellim permbushjen e veprimtarise te saj kryesore ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.**

**PJESA II**  
**KAPITALI I SHOQËRISE DHE KUOTAT**

**Neni 7**  
**Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali i shoqerise eshte 500,000 ( peseqind mijë ) Lek i marre persiper dhe i nenshkruar nga ortaket.

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 1 (nje) kuote e cila zoterohej nga ortaket si me poshte :

Ortaku	Kuotat e Nenshkruara	Vlera ne Leke	Perqindja(%)
Esmeralda Qafa	1	500,000	100%
Total	1	500,000	100%

Kapitali themeltar eshte vetem ne monedhen vendase, lek.

**III. STRUKTURA DREJTUESE  
TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE**

**Neni 8**  
**Përgjegjësia e kufizuar**

8.1. Ortaket jane përgjegjës deri në vlerën e pjesës së tyre në kapitalin e Shoqërisë. Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj me të gjitha asetet.

**Neni 9**  
**Të drejtat e lidhura me cdo kuotë**

9.1. Cdo kuote e secilit ortak do t'i përgjigjet një vote korresponduese në mbledhjet e ortakëve dhe do t'i japë ortakëve të drejtën për të marrë dividendë në rast shpërndarje të fitimit si dhe të drejtën e pjesës përkatëse që mbetet pas procedurave të likuidimit në rast prishje apo likuidimi të Shoqërisë.

**Neni 10**  
**Fitimi dhe kalimi i kuotave**



- 10.1. Kuotat e kapitalit te shoqerise fitohen apo kalohen nepermjet:
- kontibutin ne kapitalin e shoqerise;
  - shitblerjes;
  - trashegimise
  - dhurimit
  - cdo menyre tjeter parashikuar me ligj.
- 10.2. Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata do behet me shkrim.

**Neni 11**  
**Detyrimet e Ortakëve**

11.1 Ortakët kanë detyrim të paguajnë pjesën e tyre, të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë nëse ftohen në mënyrën e duhur, të mbështesin Shoqërinë në kryerjen e veprimeve të saj si dhe të përmbushin vendimet e mbledhjes së ortakëve dhe organeve të tjera të Shoqërisë të cilat janë marrë në mënyrën e duhur brenda qëllimit të organizatës.

**PJESA IV**  
**ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

**Neni 12**  
**Të drejtat e asamblesë së per gjithshme**

- 12.1 Asambleja e per gjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha cështjet e veprimtarisë së saj.
- 12.2 Asambleja e per gjithshme përbëhet nga të gjithë ortakët.
- 12.3 Vetëm asambleja e per gjithshme ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:
- ndryshime dhe modifikime të Statutit;
  - pranimin e ortakëve të rinj (pas rritjes së kapitalit apo transferimit të kuotave);
  - zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit dhe/ose cdo lloj pagimi të pjesshëm ose subvencioni të dhënë nga ortakët;
  - bashkimin, ndarjen, prishjen dhe cdo lloj transformimi të Shoqërisë;
  - blerjen apo disponimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja;
  - hapjen dhe mylljen e degëve dhe zyra e përfaqësimit;
  - pjesetimin dhe anullimin e kuotave;
  - perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
  - miratimin e raporteve vjetore dhe bilancit të shoqërise si dhe shpërndarjen e fitimit;
  - blerjen, shitjen dhe dhënien peng të pasurive të paluajtshme;
  - marrjen me qira, dhënien me qira ose dhënien e cdo të drejtë për përdorimin e pasurive të paluajtshme dhe ndërtesave;
  - të vendosë për investimet;

- (m) të japë letra me vlerë, të marrë detyrime, të lëshojë garanci ose letra sigurie
- (n) të përcaktojë parimet e përgjithshme të politikave të shoqërisë;
- (o) të caktojë shpërblimet për administratorët, të përfundojë kontratat e punës me administratorët dhe nëpunësit ekzekutivë të shoqërisë;
- (p) të japë alternativa, të drejta të ndarjes së fitimit vjetor, pagesave në natyrë, të drejtat mbi pensionet ose cdo pagesë mbi largimin e drejtoreve, dhe nëpunësve ekzekutivë të shoqërisë;
- (q) të përfundojë marrëveshje konsultimi dhe bashkëpunimi;
- (r) emerimin dhe shkarkimin e likujduesve, ekspertëve kontabël te autorizuar;
- (s) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- (t) percaktimin e shperblimeve per likujduesit, ekspertet kontabel;
- (u) mbikqyerjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët;
- (v) miratimin e rregullave të brendshme mbi administrimin dhe mbledhjes se asamblese;
- (w) përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Shoqërisë;
- (x) përcaktimin e buxhetit vjetor;
- (y) miratimin e cdo cështje tjeter zgjidhja e së cilës i është rezervuar asamblesë së përgjithshme në përputhje me ligjin dhe këtë Statut.
- (z) Marrjen e huave ne emer te shoqerise dhe vendosjen e kushteve te huase
- (aa ) Lidhjen e mareveshjeve per dhenien e huave

12.4 Asambleja e përgjithshme do të ketë të drejtë të vendosë mbi cdo cështje që tejkalon aktivitetin e përditshëm të shoqërisë.

### **Neni 13 Vendimet e asamblesë së përgjithshme**

13.1 Vendimet e renditura përsa i përket ndryshimit të statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë merren me  $\frac{3}{4}$  e votave të ortakëve pjesëmarrës.

### **Neni 14 Thirrja e asamblesë së përgjithshme**

- 14.1 Asambleja e përgjithshme do të thirret nga administratorët të paktën njëherë në vit në selinë e Shoqërisë ose ne cdo vend tjeter nëse percaktohet ne njoftim.
- 14.2 Gjithashtu, ortakët të cilet perfaqësojnë të paktën 20 për qind të totalit të votave ne asamblenë e përgjithshme të shoqërisë mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike për të thirrur asamblenë e përgjithshme. Në kërkesën drejtuar administratorëve mund të përfshihen dhe cështjet e posacme të rendit të ditës.
- 14.3 Asambleja e përgjithshme do të thirret me anë të një njoftimi të shkruar të dërguar nga administratorët, njoftim ky i cili duhet të merret nga përfaqësuesit e ortakëve nëpërmjet një letre rekomande, email , telexi apo faksi jo më pak se 7 (shtatë) ditë përpresa datës së caktuar të mbledhjes. Njoftimi i shkruar do të

registrohet në librin e procesverbalit të shoqërisë. Gjithashtu, asambleja e pergjithshme mund të thirret nëpërmjet postës elektronike me të njëjtat kushte dhe afate.

- 14.4 Njoftimi për takimin e asamblesë së pergjithshme do të tregojë datën kohën dhe vedin e takimit si dhe cështjet e rendit të ditës.
- 14.5 Nëse data për mbledhjen e ardhshme të asamblesë është vendosur në takimin e fundit dhe të gjithë ortakët kanë qënë prezentë, atëherë do të gjykohet sikur njoftimi është dërguar.
- 14.6 Nëse të gjithë ortakët janë prezentë në asamblenë e ortakëve, atëherë vendimet mund të merren dhe në mungesë të përbushjes së kërkesave formale të caktuara më sipër nëse të gjithë ortakët janë dakord.

#### **Neni 15**

#### **Vendimet e marra në asamblenë e pergjithshme**

- 15.1 Vendimet në asamblenë e pergjithshme të cilat kërkojnë një shumicë të zakonshme mund të merren vetëm nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave. Vendimet në asamblesë e pergjithshme të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar mund të merrën vetëm nëse janë të pranishëm ortakët të cilët zotërojnë më shumë së gjysmën e numrit total të votave.
- 15.2 Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 15.3 Cdo ortak ka të drejtë të thërrasë këshilltarë në mbledhjen e asamblese, të cilat do të janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e mbledhjes.
- 15.4 Nëse mbledhja e asamblese se pergjithshme thirret në mënyrë të rregullt por nuk plotësohet numri i ortakëve të caktuar për të përbushur kuorumin, atëherë asambleja do të thirret përsëri në përputhje me Nenin 14 dhe gjithmonë jo më vonë se 30 ditë me të njëtin rend dite.

#### **Neni 16**

#### **Drejtimi i mbledhjes se asamblese se pergjithshme**

- 16.1 Kryetari i mbledhjes së asamblese se pergjithshme do të caktohet nga ortakët.
- 16.2 Do të aprovojen apo refuzohen vetëm ato cështje të cilat janë përcaktuar shprehimisht në rendin e ditës për mbledhjen e asamblese. Diskutimet mbi cështje të ndryshme nga ato të rendit të ditës mund të bëhen vetëm nëse të gjithë ortakët japid pëlqimin e tyre.

**Neni 17**  
**Procesverbali i mbledhjes së asamblese se pergjithshme**

- 17.1 Për cdo mbledhje të asamblese se pergjithshme do të mbahet një procesverbal dhe do të merren vendime. Prosesverbali duhet të mbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për Shoqërinë, një për regjistrin tregëtar dhe një për secilin ortak. Prosesverbali i bashkangjitet edhe lista e pjesëmarrësve së bashku me aktin e thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
- 17.2 Prosesverbali do të firmoset nga kryetari dhe nga mbajtesi i procesverbalit.
- 17.3 Kopjet e vendimeve përkatëse të ortakëve do t'u dërgohen ortakëve me letër rekomande jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas takimit të ortakëve. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, një kopje e procesverbalit do të publikohet jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes në këtë faqe.
- 17.4 Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesvebalit dhe shpërndarjen e tij.

**PJESA V**  
**ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

**Neni 18**  
**Administrimi i Shoqërisë**

- 18.1 Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një ose me shume administratore, te cilet do të përfaqësojnë Shoqërinë. Gjithashtu, asambleja e pergjithshme mund të caktojë kompetenca përfaqësimi individuale secilit prej administratorëve.
- 18.2 Administratorët mund të autorizojnë palë të treta që t'i përfaqësojnë ata në transaksione të vecanta.
- 18.3 Administratorët do të organizojnë dhe menaxhojnë të gjithë aktivitetin e Shoqërisë. Ata janë të autorizuar të përfaqësojnë Shoqërinë në të gjitha cështjet që kanë lidhje me të.
- 18.4 Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve burojnë nga ligji, ky Statut, vendimet e Asamblese se Pergjithshme dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.
- 18.5 Administratorët kanë të drejtat e mëposhtme:
  - (a) përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
  - (b) hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
  - (c) përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave;

- (d) nënshkrimin e të gjithë dokumentave, nxjerrjen e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
- (e) mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhënien dhe marrien e paradhënieve;
- (f) dhënien e moratoriumit debtorëve të Shoqërisë, heqjen dorë nga paditë që vijnë si pasojë e marrëdhënieve të Shoqërisë me palët e treta dhe/ose pranimin e këtyre padive;
- (g) punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
- (h) marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, fillimin e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratorët mund të udhëzojnë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojnë shumën e shpërblimit të tyre; administratorët kanë të drejtë të ngrenë padi dhe t'i térheqin ato, të nënshkruajnë marrëveshje gjyqësore, të myllin marrëveshje arbitrazhi, të caktojnë arbitra, të térheqin paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërprenjnë procedimet;
- (i) administratorët kanë të drejtë marrin cdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- (j) mbledhjen e shpenzimeve të Shoqërisë;
- (k) administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e ligjit;
- (l) administratorët janë përgjegjës për përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor dhe pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga një auditor i jashtëm nëse dicka e tillë kërkohet nga ligji apo vendimi i mbledhjes së ortakëve;
- (m) thirrjen e mbledhjeve të ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmrbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së ortakëve për shpalljen e vendimeve të vecanta;
- (n) publikimin e shpalljeve të nevojshme përfshirë dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;
- (o) administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të Shoqërisë;
- (p) marrin vendime mbi të gjitha cështjet e tjera që lidhen me aktivitetin e brendshëm të Shoqërisë dhe marrëdhëni e saj të jashtme.

18.6 Personi i mëposhtëm do të caktohet administrator për një periudhë 5 (pesë) vjecare me të drejtë ripërtëritje:

- Oneido Bushi , shtetase Shqiptar , lindur me 23 Korrik 1993 ne Korce , banues ne Tirane, Shqiperi , mbajtes i leternjoftim nr\_\_\_\_\_ dhe numer personal J30723062W , madhor dhe me zotesi juridike te plote per te vepruar.

**PJESA VI**  
**VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJET**

**Neni 19**  
**Viti finansiar, pasqyrat vjetore financiare**

- 19.1 Viti finansiar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një të Dhjetorit. Viti i parë finansiar i Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit.
- 19.2 Në fund të cdo viti finansiar, administratorët do të përbushin detyrat e mëposhtme:
  - (a) përgatitjen e një liste të detajuar të aseteve të Shoqërisë dhe strukturës së tyre;
  - (b) përgatitjen e bilancit të shoqërisë i cili përshkruan situatën financiare të Shoqërisë;
  - (c) përgatitjen e llogarive të fitimit dhe të humbjeve.
- 19.3 Pasqyrat financiare të përgatitura do të paraqiten në mbledhjen e zakonshme të asamblesë së ortakëve së bashku me një raport të auditorëve të jashtëm për miratim.

**Neni 20**

**Fitimi i Shoqërie**

- 20.1 . Fitimi neto i Shoqërisë do të shpërndahet në përputhje me pjesët e kapitalit në Shoqëri.
- 20.2 . Fitimi neto do të jetë fitimi i Shoqërisë në përputhje me pasqyrat vjetore financiare të miratuara pas zbritjes së të gjitha taksave dhe caktimit të rezervave ligjore. Bilanci i shoqërisë do të miratohet nga asambleja e otakëve dhe do të dorëzohet në organet tativore përpara fundit të muajit Mars të vitit pasardhës.

**PJESA VII**  
**PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

**Neni 21**  
**Prishja dhe likuidimi**

- 21.1 Shoqëria do të zgjidhet në rastet e mëposhtme:
  - (a) vendim i mbledhjes së asamblesë së ortakëve;
  - (b) bashkimi me një shoqëri tjeter;



- (c) vendimi i gjykatës me juridiksion përkatës në rastet e parashikuara me ligj;
  - (d) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.
- 21.2 Likuidimi i Shoqërisë dhe shpërndarja e aseteve të Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore.

## PJESA VIII TE PERGJITHSHME

### Neni 22 Te pergjithshme

- 22.1 Në rast mosmarrëveshjes të cilat lindin si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, ortakët do të përpiken t'i zgjidhin ato miqësish. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata me juridiksion përkatës.
- 22.2 Ligji zbatues është ligji shqiptar.
- 22.3. Ky statut hartohet dhe nënshkruhet në 2 ( dy ) kopje origjinale.

Tirane me 6 Prill 2021

### ORTAKU I VETEM

Esmeralda Qafa

*Esmeralda Qafa*

*Egj*